



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore – Lyerje ndërtesash”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**45442110-1 Lyerje ndërtesash;**

**50000000-5 Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi;**

VLERA E FONDIT LIMIT:

**9,206,264** (nëntë milion e dyqind e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, i ndarë si më poshtë:

Për Fakultetin e Mjekësisë: 7,083,100 (shtatë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike: 2,123,164 (dy milion e njëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

- b. *Formulari i ofertës dhe çmimit, sipas shtojcës 1 dhe 2;*  
c. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës përkatësisht 3,682,505.6 (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesë pikë gjashtë) lekë pa TVSH. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Shënim:* Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

**2.2.3.** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë liçencë profesionale të shoqërisë e vlefshme, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuar me ligj, me kategoritë e mëposhtme:

- **NP-3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale
- **NS -1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **NS -4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj

***Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 8 të ligjit Nr. 8402, datë*

10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe në pikën 1/a, 1/b, 2/a dhe 2/b, Kreu III të VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjeteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

---

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjeteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kategoritë e licensës “NP dhe NS” të përcaktuara janë hartuar në përputhje me zërat konkret që përmban preventivi (Punime prishje suvatimi, Punime suvatim i brendshëm, Punime lysterje).

Me qëllim realizimin e shërbimit, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gërmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës. Përcaktimi i nënkategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave të secilit volum pune.

---

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL), me Kodin III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane/Inerte”.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin 79, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, dhe nenit 44 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 57 të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe fushës III të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit(QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, për të garantuar realizimin e shërbimeve në përputhje me detyrimet për mbrojtjen e mjedisit.

Përcaktimi i kategorisë së liçensës është bërë duke patur parasysh preventivin dhe volumet, pasi krahas punimeve të prishjeve, përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngurta urbane, transport i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve.

---

**2.3.4.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajtë e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 duhet të deklarohet emër mbiemër, numri diplomës së inxhinierit të kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe gërma b, pika 4, neni 41 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për nevojën e pranisë së Inxhinierit në objekt, është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve ku duke marrë në konsideratë zërat që duhet të realizohen rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierin e ndërtimit i cili në bashkëpunim dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Zërat që duhet të realizohen janë prishje suva, transport, suvatim mure, lyerje me bojë, të cilat shtrojnë domosdoshmërinë dhe nevojën për prezencën e inxhinierit të kërkuar.

**2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar / të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi;
- 10 (dhjetë) punonjës bojaxhi;
- 2 (dy) punonjës suvatues;
- 12 (dymbëdhjetë) punonjës të thjeshtë.

Për punonjësit me profesionet më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës
1			
2			
3			

Për punonjësit e mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Kontratë individuale pune e vlefshme;
- b) Listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajtë e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave;
- c) Dokumentin që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas Ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe gërma b, pika 4, neni 41 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të realizimit të shërbimit, që është përlllogaritur në një kohë të shkurtër

prej 1 (një) muaj, për shkak të nisjes së procesit mësues në ambientet ku do të realizohet ljerja e godinave, i cili kërkon fuqi punëtore dhe mjetet e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate brenda afateve të caktuara. Janë 6 (gjashtë) ambiente për të cilat kërkohet shërbimi i ljerjes, ndaj ky numër punonjësish është i domosdoshëm për realizimin në kohë të kontratës.

**2.3.6.** Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës të kualifikuar/çertifikuar si *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"* në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"* dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajtë e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë")*.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për 1 (një) punonjës *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"* është vendosur sipas përcaktimeve të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"*, si dhe gërma b, pika 4, neni 41 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 *"Për sigurinë dhe shëndetin në punë"*, sipas të cilit: *"Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë....."*.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me vendin e realizimit të shërbimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një vendi të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të realizimit të shërbimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të çertifikuar si *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"*, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve (ljerja e tyre) sipas standardeve ligjore në fuqi.

**2.3.7.** Një punësim mesatar i të paktën 27 (njëzet e shtatë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajtë e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajtë e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 (tre) muajtë e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në pikën 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"*, si dhe gërma b, pika 4, neni 41 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 27 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut të realizimit të shërbimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 1 (një) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 *“Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”*, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

**2.3.8.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- Çertifikatën për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në



standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 10 gërma “a”-“b”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

**2.3.9.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve/ ose skedat teknike të lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, për bojën hidroplastike, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet përkatëse të kërkuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat e specifikimeve teknike në DT.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe garantojnë origjinalitetin dhe cilësinë e materialeve që do të përdorin për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, dhe nisur nga tipologjia e objektit të prokurimit me punime dhe shërbime që parashikohen të realizohen sipas preventivit, si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti (godina me akses nga studentët pasi aty realizohet mësimi), duhet të garantohet që mallrat kryesore për realizimin e shërbimit të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Në mënyrë që AK të verifikojë që specifikimet teknike të bojës së propozuar nga OE plotësojnë parametrat dhe standardet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, me qëllim përmbushjen e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si katalogë/broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve, ose skedat teknike të lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë për bojën hidroplastike, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet përkatëse të kërkuara.

**2.3.10.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Mjet transporti vetshkarkues deri në 3.5 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
2	Karroçë dore	copë	6	Në pronësi ose me qera
	<b>Mjete mbrojtëse</b>			
3	Helmetë mbrojtëse për kokën	copë	27	Në pronësi ose me qera
4	Jelekë me shirita fosforishentë	copë	27	Në pronësi ose me qera

5	Fikse Zjarri të lëvizshme minimumi 5 kg	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Tabela Sigurimi Teknik	copë	10	Në pronësi ose me qera
7	Kuti Ndhmeës së shpejtë	copë	2	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara më sipër, të cilët duhet të disponojnë dokumentacionin si më poshtë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit janë:

- a) *Për pajisjet, që janë në pronësi, të disponohet fatura tatimore e shitjes/akti i zhdoganimit/kontratat e dhurimit apo të blerjes së tyre në ankande publike, me kusht që të provohet me dokumentacion të rregullt nga ana e operatorëve ekonomikë.*
- b) *Për pajisjet, që janë me qera, të disponohet kontrata e qirasë me afat sa realizimi i kësaj kontrate dhe fatura tatimore e shitjes/akti i zhdoganimit/kontratat e dhurimit apo të blerjes së tyre në ankande publike, me kusht që të provohet me dokumentacion të rregullt nga ana e operatorëve ekonomikë.)*
- c) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, taksat, si dhe polica e sigurimit, të vlefshme të mjetit.*
- d) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira, të disponohet kontrata e qirasë, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, taksat, si dhe polica e sigurimit, të vlefshme të mjetit.*
- e) *O.E. duhet të deklarojë që mjetet e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe vendndodhjen e tyre (adresën e saktë).*
- f) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim për të provuar kapacitetet teknike të OE të cilat do të angazhohen në plotësimin e kushteve të kontratës sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, në afatin e kërkuar, si dhe në përputhje me detyrimet ligjore të lejuara të lëvizjeve të mjeteve të rënda. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, i ndryshuar.

Kërkesa për disa nga mjetet kryesore të veçanta është bërë bazuar në shërbimet e kërkuara, kështu mjetet e transportit (3) *Mjete transporti vetshkarkues deri në 3.5 ton* do të bëjnë të mundur transportin e materialeve të nevojshme për kryerjen e punimeve njëkohësisht dhe transportin e mbetjeve që rezultojnë nga prishjet, për në vendin e caktuar nga Bashkia. Numri i mjeteve të transportit është përcaktuar nisur nga fakti vendi i kryerjes së shërbimeve është i shtrireë në 6 (gjashtë) objekte të ndryshme, brenda Kompleksit Spitalor Universitar “Nënë Tereza“ dhe të godinës së Fakultetit të

Mjekësisë të ndodhur në afërsi, si dhe grafikut të realizimit të shërbimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 1 (një) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të përkthyer dhe të noterizuara, nëse janë në gjuhë të huaj.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të administratorit të UMT-së me nr. 158, datë 17.07.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin, modifikimin e preventivave, hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore - Lyerje ndërtesash”, nr. 2297/1 prot, datë 17.07.2023, i cili ka hartuar relaconin për rishikimin, modifikimin e preventivave, hartimin e specifikimeve teknike me nr. 2297/2 prot., datë 18.07.2023.

Bashkëngjitur Procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim dhe Dokumentave Standarde të Tenderit do të jenë specifikimet teknike për objektin: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore- Lyerje ndërtesash”.

## TERMAT E REFERENCËS

### Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

“Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore – Lyerje ndërtesash”

### Detyrat:

Kontraktuesi duhet t’i vërë në dispozicion grupit që do të ndjekë zbatimin e kontratës njoftimet përkatëse për fillimin e shërbimeve, dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm që e gjykon të nevojshëm.

### Shpërndarja:

Realizimi i shërbimit do të bëhet sipas kërkesës së AK në preventiv, nëpërmjet përfaqësuesve të tij.

### Vendi i kryerjes së shërbimeve:

- Godina e Paraklinikut me adresë: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Rruga e Dibrës
- Salla e Kirurgjise me adresë: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Rruga e Dibrës
- Salla Galileo, me adresë: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Rruga e Dibrës
- Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë kati përdhe, Rektorati i UMT-së, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005 – Tiranë
- Godina 6 Katëshi, me adresë: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Rruga e Dibrës
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, me adresë: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Rruga e Dibrës

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me pjesën teknike janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore – Lyerje ndërtesash**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

### Bashkëlidhur këtij procesverballi:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Preventivi pa çmime*
- *Specifikimet teknike*

### Njësia e Prokurimit:

- **Inxh. Edison Imeri**      **Përgjegjës SSHI, DSHM, UMT**
- **Ilva Ymeraj**              **Përgjegjës SP, DSHM, UMT, Person përgjegjës për prokurimin**
- **Entela Bilbili**            **Specialist prokurimesh, Fakulteti i Mjekësisë**

